

AKT-THEMELIMI
I SHOQERISE AKSIONERE
“FTG” sh.a.

Sot, më datë 01.08.2019, me ane të ketij dokumenti, të hartuar në 4 (kater) kopje origjinale,

Aksioneret e shoqërisë janë:

1. Shoqëria “interweb.al” sh.p.k. person juridik, regjistruar në regjistrin tregtar më datë 1.11.2013, me NUIS L32301103Q, me seli në adresën Rruga Pjeter Bogdani, 3, Tiranë, me përfaqësues ligjor Z. Klajdi Oshafi, mbajtës i kartes ID me numer personal I71010088D

dhe

2. Shoqëria “Gjoka Konstruksion” sh.a. person juridik, regjistruar në regjistrin tregtar më datë 24.3.1999, me NUIS J91815014U, me seli në adresën Njesia 5, Rruga: Dora D'Istria, Hyrja nr. 6, Tiranë, me përfaqësues ligjor Z. Rrok Gjoka, mbajtës i kartes ID me nr. personal F10104114F

dhe

3. Shoqëria “MiscoM” sh.p.k. person juridik, regjistruar në regjistrin tregtar më datë 30.6.2016, me NUIS L61830014C, me seli në adresën Rruga Selite e vjeter, Pallati Syri i Liqenit, Kati Perdhe, Nr.7, Tiranë, me përfaqësues ligjor znj. Hamide Selimi, mbajtëse e pashaportes nr. K00175412

- 1) Kohezgjatja e aktivitetit të shoqërisë fiksohet për një periudhë kohe të pakufizuar.
- 2) Shoqëria ka si objekt të veprimtarisë së saj:
 - Importimin e pajisjeve fiskale në Republikën e Shqipërisë;
 - Tregtimin e pajisjeve fiskale të subjektet tatimpaguese në Republikën e Shqipërisë;
 - Programimin, instalimin e fiskalizimit të pajisjeve fiskale të tregtuara;
 - Mirëmbajtjen e pajisjeve fiskale, pas fiskalizimit;
 - Tregtimin dhe mirëmbajtjen e pajisjeve elektronike;
 - Krijimin, zhvillimin dhe mirëmbajtjen e software që do të përdoren për pasigjet fiskale si dhe për sisteme kontabiliteti.
- 3) Për përmbushjen e objektit të veprimtarisë, shoqëria mund të marrë pjesë në bashkëpunim me shoqëri të tjera që kanë objekt të njejte ose të përafert me të sajën dhe mund të kryejë direkt apo indirekt të gjitha operacionet e nevojshme për realizimin e objektit të saj.

Shoqëria mund të hapë dhe të mbajë llogari rrjedhese në lekë apo valuata të tjera, pranë bankave shqiptare apo të huaja, duke mundur gjithashtu të disponojë lirisht mjetet monetare të akumuluar në to, konform legjislacionit në fuqi.
- 4) Selia e shoqërisë është në adresën: Rruga Enriko Telini, Godina Neza, nr.3, Tiranë, Shqipëri. Këshilli i Administrimit ka kompetencën të hapë filiale e agjensi të tjera dhe t'i mbyllë nëse e quan të nevojshme.
- 5) Kapitali themeltar i shoqërisë është 3.600.000 (tremilion e gjashtëqind mijë) lekë. Kapitali themeltar i shoqërisë është i ndarë në 3.600 (tremijë e gjashtëqind) aksione me vlerë nominative 1000 (një mijë) lekë secili. Aksionet janë të zakonshme dhe të pandashme. Kapitali themeltar është nënshkruar dhe është shlyer në një të katërtën e vlerës së tij nga aksioneret themelues si me poshte:

Shoqëria "interweb.al" sh.p.k. zotëron 1 200 aksione dhe ka nenshkruar dhe ka shlyer shumen 300.000 (treqindmijë) lekë që i perket 300 aksione.

Shoqëria "Gjoka Konstruksion" sh.a. zotëron 1 200 aksione dhe ka nenshkruar dhe ka shlyer shumen 300.000 (treqindmijë) lekë që i perket 300 aksione.

Shoqëria "MiscoM" sh.p.k. zotëron 1 200 aksione dhe ka nenshkruar dhe ka shlyer shumen 300.000 (treqindmijë) lekë që i perket 300 aksione.

6) Administrator i shoqërise, i emëruar për një periudhë kohe 3-vjecare me të drejtë rimerimi është **Z. Klajdi Oshafi**. Ai ka të drejtën e firmës dhe të përfaqesimit të shoqërise.

Administratori gëzon kompetenca të pakufizuara për realizimin e objektit të veprimtarisë së shoqërise, me përjashtim të kompetencave që janë ngarkuar, këshillit të administrimit dhe asamblese së përgjithshme.

Në përmbushje të detyrës së tij mund të vërë në levizje instanca juridike dhe administrative, duke emëruar avokate e duke leshuar prokurë në rastë gjyqesh, të kryejë operacione bankare, përfshirë këtu edhe hapjen e llogarive rrjedhese, nenshkrimin dhe xhirimin e ceqeve, realizimin e terheqjeve dhe derdhjeve me leke në dorë apo urdher-xhirimi, tituj krediti, paradhënie krediti.

Administratori në përfundim të çdo viti ekonomik përpilon një raport mbi aktivitetin e zhvilluar, objektivat e arritura dhe perspektivën e shoqërise, si dhe përgatit bilancin përfundimtar që ia paraqet çdo vit Asamblese për aprovim.

Këshilli i Administrimit përbëhet prej 3 (tre) anëtarësh të zgjidhen nga Asambleja e Përgjithshme.

Përberja e Këshillit të Administrimit është si më poshtë:

- a. Stela Oseku e dtl. 27.02.1990, mbajtëse e kartës ID me nr. personal J05227081R
- b. Elvis Gjoka i dtl. 19.11.1979, mbajtës i kartës ID me nr. personal H91119114A
- c. Mirsin Selimi i dtl. 24.12.1979, mbajtës i kartës së identitetit me nr. 005149709

Kohezgjatja e funksionit të anëtarëve të Këshillit të Administrimit është 3 (tre) vjet. Anëtarët e Këshillit të Administrimit, kanë të drejtë të rizgjidhen. Ata mund të shkarkohen në çdo kohë nga Asambleja e Përgjithshme.

Kompetencat e funksionimit të tij rregullohen nga statuti bashkëlidhur.

Ekspert kontabel i Shoqërise emërohet Berti Pashko i dtl. 22.01.1963, mbajtës i kartës ID me nr. personal G30122080K me Licence Nr. 7 date 10.01.2000, për një afat 3 (tre) vjeçar.

- 7) Viti ekonomik fillon më 1 Janar dhe mbaron më 31 Dhjetor të çdo viti.
- 8) Në një libër të posaçëm të shoqërise shënohet kapitali themeltar, vlera e kontributit dhe aksionet e aksionerit të vetëm.

Në përfundim të vitit ekonomik, pas aprovimit të bilancit, Asambleja pasi ka ndarë fondet për likuidimin e detyrimeve ndaj të tretëve, detyrimet fiskale ndaj shtetit, rezervat e detyrueshme, vendos për ndarjen e fitimit neto. Për humbjet përgjigjet ekskluzivisht shoqëria me kapitalin e saj.

9) Aksioneret mund ta zmadhojne kontributin e tyre, duke depozituar fitimet e realizuara nga aktiviteti i shoqerise, konforme asaj se parashikuar ne Statutin e shoqerise.

10) Aksioneret, Administratori dhe Anetaret e Keshillit te Administrimit jane te detyruar te ruajne sekretin mbi dokumentacionin dhe te dhenat, njohurite dhe eksperiencat e fituara gjate aktivitetit te shoqerise, dhe marrin te gjitha masat e nevojshme te sigurise per te evituar perhapjen, qofte edhe pjeserisht.

Ata jane pergjegjes per pasojat negative qe mund te vijne nga shkelja e dispozites se mesiperme. Sa siper vlen edhe per edhe per Ekspertin Kontabel te Miratuar.

Aksioneri i Vetem eshte pergjegjes, ndaj te tretteve per demet qe mund t'u shkaktohen nga anulimi apo deklarimi i pavlefshem i ketij akti themelues.

Per sa nuk specifikohet shprehimisht ne kete akt, vlejne normat e Statutit bashkangjitur.

Paralelisht me nenshkrimin e ketij akti, aksioneri i vetem nenshkruan edhe Statutin e shoqerise "FTG" sh.a., i cili i bashkalidhet aktit te themelimit dhe eshte pjese perberese e tij.

Interweb.al sh.p.k.

Gjoka Konstruksion sh.a.

MiscoM sh.p.k.

Klodian Dzhafaj

Rozet Gjokaj

Humbert Gjokaj

